Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-016
Prishtinë, më 27 korrik 2021, në orën 15:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 27 KORRIK 2021

Në mbledhje morën pjesë: Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit; Saranda Bogujevci, Bedri Hamza, Kujtim Shala dhe Bekim Arifi, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare në mbledhje morën pjesë: Mimoza Kusari-Lila, Abelard Tahiri, Armend Zemaj, Time Kadrijaj dhe Enis Kervan.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi, si dhe stafi përgjegjës në mbështetje të Kryesisë së Kuvendit.

Mbledhjen e drejtoi Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit.

Në fillim, Kryesia e Kuvendit e mbajti një minutë heshtje në nderim të viktimave të mërgimtarëve tonë që e humbën jetën nga aksidenti tragjik në Kroaci.

Pastaj, me propozimin e kryetarit, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme të Kryesisë së Kuvendit,

2. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 16, 19 dhe 21 korrik 2021,

3. Pika e papërfunduar nga seanca plenare, e mbajtur më 22 korrik 2021,

4. Përgatitjet për seancë plenare,

5. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme të Kryesisë së Kuvendit

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 19 korrik 2021.

2. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 16, 19 dhe 21 korrik 2021

3. Pika e papërfunduar nga seanca plenare, e mbajtur më 22 korrik 2021

Kryesia, pasi diskutoi për pikat e papërfunduara të dy seancave të Kuvendit, nga pikat 2 dhe 3 të lartshënuara, vendosi që vazhdimi i tyre të mbahet të mërkurën, më 28 korrik 2021:

I. Vazhdimi i seancës plenare me pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 16, 19 dhe 21 korrik 2021 do të mbahet të mërkurën, më 28 korrik 2021, në orën 14:00, me këtë:

Rend dite

4. *Votimi i Projektligjit nr.08/L-006 për ratifikimin e amendamentimit të Marrëveshjes ndërkombëtare me Bankën Evropiane për Investime (BEI), për financimin e Projektit për rehabilitimin e linjës hekurudhore 10,*
5. *Votimi i Projektligjit nr. 08/L-019 për amendamentimin 02 të Marrëveshjes bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e bashkëpunimit për zhvillim "KSV/017: Programi për mbështetje shëndetësore (pjesa II),*

6. *Votimi i Projektligjit nr. 08/L-008 për ratifikimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim për zbatimin e Projektit "Hulumtimi dhe shkencat e aplikuara në arsimin e lartë + (HERAS+) (ada numri referues 8116-00-2020)",*

7. *Votimi i Projektligjit nr. 08/L-009 për ratifikimin e amendamentimit nr.1 të Marrëveshjes kornizë së kredisë të datës 14 gusht 2020 ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës për financimin e projektit "Reagimi Emergjent ndaj COVID-19",*

11. *Votimi i kërkesës së Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë për ndryshimin e emërtimit të këtij komisioni,*

13. *Propozim-rezoluta nga debati parlamentar për zbatimin e Marrëveshjes së Uashingtonit,*

14. *Propozimi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës për zëvendësimin e anëtarit në komision parlamentar,*

15. *Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2020.*

II. Vazhdimi i seancës plenare me pikën e papërfunduar nga seanca plenare, e mbajtur më 22 korrik 2021, do të mbahet po ashtu të mërkurën, më 28 korrik 2021, në orën 15:00, me këtë:

Rend dite

13. *Votimi i rekomandimeve të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me raportin e auditimit të pasqyrave vjetore financiare të N.P. Hortikultura për vitin 2020.*

4. Përgatitjet për seancë plenare

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme, vendosi që seanca plenare e radhës e Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbahet të hënën, më 2 gusht 2021, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Deklarimet jashtë rendit të ditës,*
2. *Pyetjet parlamentare,*
3. *Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për themelimin e institucionit të Operës së Kosovës si institucion i shërbimit publik,*
4. *Debat parlamentar lidhur me punën njëqindditore të Qeverisë së Republikës së Kosovës,*
5. *Zgjedhja e kryesuesit dhe dy (2) anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,*
6. *Zgjedhja e tre (3) anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Mediave.*

* * *

Me propozim të kryetarit, Kryesia vendosi që në rendin e ditës të seancës plenare të radhiten edhe pikat e lartshënuara me nr. 5 dhe nr. 6, pasi që Komisioni Funksional dhe Komisioni ad hoc ndërkohë i kanë proceduar raportet e tyre, si dhe i plotësojnë kushtet formale për procedim.

* * *

5. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave:

5.1. Kërkesa e gjashtë (6) deputetëve nga GP i PDK-së për debat parlamentar lidhur me Marrëveshjen e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për "Tiketë ngjitëse"

Kryetari i GP të PDK-së, Abelard Tahiri, në emër të deputetëve parashtrues e tërhoqi kërkesën për të cilën kishin kërkuar debat parlamentar lidhur me Marrëveshjen e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për "Tiketë ngjitëse", me arsyetimin se Ministria përkatëse e ka pezulluar vendimin në lidhje me këtë marrëveshje.

5.2. Kërkesa e nëntë (9) deputetëve nga GP i PDK-së për debat parlamentar lidhur me punën njëqindditore të Qeverisë së Republikës së Kosovës

Kryesia vendosi që kërkesën e lartshënuar ta radhisë në rendin e ditës të seancës plenare, e cila do të mbahet, më 2 gusht 2021.

5.3. Rishpallja e konkursit publik për dy (2) anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga radhët e komuniteteve joshqiptare

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me rishpalljen e konkursit të lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Të rishpallet konkursi publik për zgjedhjen e dy (2) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga radhët e komuniteteve joshqiptare.

2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që në bazë të dispozitave të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më 23 gusht 2021 ta publikojë rishpalljen e konkursit publik nga pika një (1) e këtij vendimi.

5.4. Propozim-vendimi i Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë për formimin e grupeve të miqësisë

Kryesia, me propozim të Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë, mori këtë:

V E N D I M

Për formimin e grupeve të miqësisë

I. Formohen 56 grupe të miqësisë ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës me parlamentet e shteteve tjera për Legjislaturën VIII të Kuvendit, si në vijim:

1. Grupi i Miqësisë me Afrikën Veriore,
2. Grupi i Miqësisë me Afrikën Qendror e Jugore,
3. Grupi i Miqësisë me Arabinë Saudite,
4. Grupi i Miqësisë me Austrinë,
5. Grupi i Miqësisë me Australinë, Zelandën e Re dhe shtetet tjera të Oqeanisë,
6. Grupi i Miqësisë me Bangladeshin,
7. Grupi i Miqësisë me Belgjikën,
8. Grupi i Miqësisë me Bosnjë-Hercegovinën,
9. Grupi i Miqësisë me Bullgarinë,
10. Grupi i Miqësisë me Danimarkën,
11. Grupi i Miqësisë me Egjiptin,
12. Grupi i Miqësisë me Emiratet e Bashkuara Arabe,
13. Grupi i Miqësisë me Estoninë,
14. Grupi i Miqësisë me Finlandën,
15. Grupi i Miqësisë me Francën,
16. Grupi i Miqësisë me Holandën,
17. Grupi i Miqësisë me Hungarinë,
18. Grupi i Miqësisë me Irlandën,
19. Grupi i Miqësisë me Japoninë,
20. Grupi i Miqësisë me Turqinë,
21. Grupi i Miqësisë me Ganën,
22. Grupi i Miqësisë me Gjermaninë,
23. Grupi i Miqësisë me Greqinë,
24. Grupi i Miqësisë me Italinë,
25. Grupi i Miqësisë me Izraelin,
26. Grupi i Miqësisë me Jordaninë,
27. Grupi i Miqësisë me Kanadanë,
28. Grupi i Miqësisë me Katarin,
29. Grupi i Miqësisë me Kroacinë,
30. Grupi i Miqësisë me Kuvajtin,
31. Grupi i Miqësisë me Letoninë,
32. Grupi i Miqësisë me Lituaninë,
33. Grupi i Miqësisë me Luksemburgun,
34. Grupi i Miqësisë me Maltën,
35. Grupi i Miqësisë me Maqedoninë e Veriut,
36. Grupi i Miqësisë me Malin e Zi,
37. Grupi i Miqësisë me Malajzinë,

38. Grupi i Miqësisë me Mbretërinë e Bashkuar,
39. Grupi i Miqësisë me Norvegjinë,
40. Grupi i Miqësisë me Panamanë,
41. Grupi i Miqësisë me Poloninë,
42. Grupi i Miqësisë me Portugalinë,
43. Grupi i Miqësisë me Qipron,
44. Grupi i Miqësisë me Republikën e Çekisë,
45. Grupi i Miqësisë me Republikën e Koresë,
46. Grupi i Miqësisë me Rumaninë,
47. Grupi i Miqësisë me Spanjën,
48. Grupi i Miqësisë me Suedinë,
49. Grupi i Miqësisë me Sllovakinë,
50. Grupi i Miqësisë me Sllovenine,
51. Grupi i Miqësisë me Shqipërinë,
52. Grupi i Miqësisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës,
53. Grupi i Miqësisë me Tajlandën,
54. Grupi i Miqësisë me Tunizinë,
55. Grupi i Miqësisë me Vatikanin,
56. Grupi i Miqësisë me Zvicrën.

* * *

Kryesia, po ashtu në lidhje me formimin e grupeve të miqësisë të lartshënuara nxori edhe këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga grupet parlamentare të PDK-së, të LDK-së dhe të Listës serbe që deri të premten, më 30 korrik 2021, t'i propozojnë deputetët për anëtarë në grupet e miqësisë sipas vendimit për formimin e grupeve të miqësisë.

2. Kërkohet nga Administrata e Kuvendit që deri në mbledhjen e radhës së Kryesisë së Kuvendit ta përgatisë formulën për ndarjen e kryesimit: për kryetarë dhe nënkryetarë të grupeve të miqësisë në proporcion me numrin aktual të deputetëve që kanë grupet parlamentare, sipas formulës për komisionet parlamentare.

* * *

Në vazhdim, Kryesia e shqyrtoi edhe këtë pikë shtesë:

1. Kërkesa për blerjen dhe riaktivizim të licencave zyrtare për një vit - në platformën online Zoom për nevojat e Kuvendit

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Lejohet pagesa në shumën prej 3 500 euro për blerjen dhe riaktivizim të licencave zyrtare për një vit - në platformën online Zoom për nevojat e Kuvendit, përkatësisht për dhjetë (10) llogari (Host), një (1) webinar dhe dy (2) konektor SIP.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë në orën 16:07 minuta.

Glauk KONJUFCA

_____

Kryetar i Kuvendit

Procesverbalin e hartoi:
Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale